



PROCESVERBALI

Mbledhja e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSBB) në Rahovec, e mbajtur më **09.12.2022** me fillim në ora **15:00**. Mbledhjen e kryesoit kryetari komunës **Smajl Latifi**. Kuorum përmblajtjën e mbledhjes kemi.

Kryetari - Më lejoni t'i përshtendes të gjithë anëtarët e KKSBB-së. Përshtendes nënkryetarin e komunës, Fatmir Iska, drejtoret e drejtive, komandantin e stacionit të policisë në Rahovëcit z. Fazli Morina, oficerin e FSK-së, përfaqësuesit e OSBE-së, përfaqësuesit e LMT-së, përfaqësuesit e bashkësive fetare, përfaqësuesit e mediave dhe gjithë të pranishmit e tjerë. Është mbledhja e 7-të e rregullt e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi. Për këtë mbledhje propozoj këtë:

Rend Dite

- 1. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;**
- 2. Vlerësimi i përgjithshëm i gjendjes së sigurisë në territorin e komunës së Rahovëcit;**
 - Vetëdijesimi përrrezikun e përdorimit të mjeteve piroteknicë;
 - Menaxhimi i trafikut - parkingjeve në qytet dhe lirimi i trotuareve;
 - Mikpritja e bashkatdhatarëve përfestat e fundvitit;
- 3. Shqyrtimi dhe aprovimi i Planit të Punës së KKSBB-së për vitin 2023;**
- 4. Të ndryshme**

Kryetari – A ka ndonjë koment rreth rendit të ditës? Propozim për ndonjë pikë të re ose ta heqim ndonjë prej këtij rendi të ditës. Nëse jo, atëherë e hedhim në votim rendin e ditës rendin e ditës. Kush është për?...A ka votë kundër?...Abstenime?... Faleminderit, miratohet rendi i ditës. Vazhdojmë...

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;

Kryetari – A ka dikush ndonjë vërejtje apo sugjerim, këshill ose koment rreth procesverbalit? Besoj që e keni lexuar të gjithë. Nëse jo, atëherë po e vendosim në votim. Kush është për?... Kundër?... Abstenime?... Miratohet procesverbal nga mbledhja e kaluar.

2. Vlerësimi i përgjithshëm i gjendjes së sigurisë në territorin e komunës së Rahovëcit;

Kryetari – Ne jemi të bindur që zhvillimet dhe lajmet e fundit, nuk e cenojnë rendit kushtetues, sundimin e ligjit dhe sigurinë publike të qytetarëve të komunës së Rahovëcit. Sipas përvojës që kemi, gjatë festave të fundvitit përdorimi i mjeteve piroteknicë është evident. Në raste të tilla, komuna e Rahovëcit nxjerr një urdhëresë për mospërdorimin e mjeteve piroteknicë në mjjedise publike apo në hapësira ku mund ta prishin klimën publike etj... Me kohë, sigurisht do ta kemi një vendim që përdorimi i mjeteve piroteknicë, pavarësisht që duhet të ndalet atje në burim apo doganë, ne do të jemi shumë të interesuar që edhe kësaj radhe përdorimi i këtyre mjeteve të jetë i kufizuar dhe maksimalisht i arsyeshëm. Menaxhimi i trafikut – parkingjeve në qytet dhe lirimi i trotuareve është nënpikë kësaj radhe sepse tani është koha që presim të kemi një fluks dhe një numër më të madh të qytetarëve që vijnë nga shtetet perëndimore. Policia sigurisht që do të ketë plan operativ. Në angazhime të përbashkëta do të kemi një menaxhim më të përgjegjshëm të trafikut dhe parkingjeve në qytet. Mikpritja e bashkatdhatarëve poashtu është një pozicion i rëndësishëm që duhet ta diskutojmë sot. Brenda 10 dite presim të vijnë shumë prej tyre. Ata përvëç që e

gjallerojnë vendin, e ndihmojnë në mënyra të ndryshme dhe natyrisht duhet t'i ofrojmë kujdes të shtuar dhe ngrrohtesi ne si KKSBB, si komunë, si polici dhe si vellezër e motra që i kemi.

Fazli Morina – Faleminderit kryetar, përshëndetje për të gjithë. Po e shfrytëzoj rastin t'i uroj sukses në punë Besës, anëtares së re të KKSBB-së. Sa i përket situatës së sigurisë, në zonën tonë të përgjegjësisë, konsiderohet situatë e qetë dhe stabile pa ndonjë ndryshim të theksuar. Gjatë kësaj kohe nga takimi i fundit që e kemi mbajtur, kemi pasur shumë aktivitete; 36 vepra penale, 2 incidente jopenale. (1 rast vjedhje, 6 vjedhje të rënda). Rastet e dhunës në familje përfat të mirë janë në rënienë këtë muaj. Armëmbajtje pa leje dhe konfiskim i 1 arme gjithashtu. Sulm ndaj personit zyrtar gjatë kryerjes së detyrës zyrtare, ndoshta edhe për shkak të obligimit moral, zyrtar dhe ligjor duhet në pika të shkurta t'iu sqaroj pjesën zyrtare të rastit dje në Hoçë të Madhe sepse ka bërë bum të madhe në media; Siç iu thash, ky rast është pengim i kryerjes së detyrës zyrtare, sulm ndaj personit zyrtar në kryerje të detyrës zyrtare me datë 08.12.2022 në fshatin Hoçë e Madhe. Njësiti policor në kuadër të stacionit policor në Rahovec, të mbështetura nga njësitet për reagim të shpejtë nga drejtoria rajonale e policisë në Gjakovë, kemi asistuar me njësitet e doganës së Kosovës gjatë operacionit lidhur me konfiskimin e një sasie të mallit të një biznesi lokal (prodhimi i verës). Pronari operonte pa autorizim të doganës dhe në kundërshtim me normat përkatëse të kodit doganor dhe akcizave. Gjatë kryerjes së detyrës, një numër i banorëve të këtij fshati (rreth 150) kanë provuar ta pengojnë sekuestrimin e mallit, fillimisht duke hedhur gjësende të forta (gurë) në rrugë dhe duke penguar fizikisht ofrimin e zyrtarëve tek objekti i biznesit. Gjatë reagimit një zyrtar policor është lënduar, mund ta them lirisht që ky zyrtar jam unë, përfat të mirë lëndimi është i lehtë dhe kalues. Gjatë sekuestrit të mallit, njësitet policore kanë ofruar sigurinë për zyrtarët e doganës, duke larguar protestuesit në një distancë të nevojshme përlirim të rrugës. Sekuestrimi ka përfunduar rreth orës 18:15 dhe kanë vazhduar me procedurat e tyre.

Ne jemi duke implementuar planin operativ “Siguria në trafikun rrugor” dhe planin “Lirimi i hapësirave publike nga automjetet”. Bazuar në këtë plane gjatë periudhës raportuese janë shënuar gjithsej 567 gjoba në trafik, 129 përparkingje të parregullta, 5 kundërvajtje të prishjes së rendit dhe qetësisë publike. Vazhdon edhe plani operativ “Siguria në shkolla” dhe gjatë periudhës raportuese janë zhvilluar disa aktivitete me karakter parandalues dhe ndërgjegjësues, janë mbajtur ligjérata në 9 shkolla me temën “Masat e sigurisë ndaj keqpërdorimi të internetit”, ligjérata në 3 shkolla me temës “Parandalimi i dhunës në familje dhe në baza gjinore” – Në kuadër të fushatës sensibilizuese “Aktivizim kundër dhunës në bazë gjinore” janë realizuar 3 takime organizative me DKA-në në Rahovec, 29 vizita në shkolla, 3 pika kontrolli dhe 99 patrullime afër shkollave. Sa i përket rasteve në shkolla të ndodhura gjatë kësaj periudhe, kemi; Një asgjësim të pasurisë, një lëndim të lehtë trupor, një vjedhje e rëndë, një kanosje dhe një posedim i paautorizuar i armës.

Kryetari – Faleminderit komandant. Si qytetar, si kryesues i KKSBB-së dhe si kryetar komune e keni mbështetjen e plotë për çdo veprim që është në përputhje me ligjin. Veprimi djeshëm i policisë dhe shembulli personal i komandantit në menaxhim të situatës së sigurisë që edhe mua si kryetar në përputhje me përgjegjësitë më ka informuar. Shembull që duhet të ndiqet edhe nga komendantët tjerrë nëpër stacione policore, në përpjekje të zbatimit të ligjit. Ia shpreh edhe solidaritetin që lëndimi të jetë i lehtë dhe të kalohet më shpejtë. Sa i përket një paqartësie që ka qarkulluar në lagjen e epërme ku jetojnë serbët. Donatorët aty nuk kanë qenë në dijeni që duhet të aplikojnë për leje pune, kur kemi ndërhyrje në hapësirë publike. Në funksion të zbatimit të ligjit organet komunale, kanë arritur ta nënshkruajnë një akt falënderimi për banorët që kanë dhënë kontributin e vet që të rinojohet ajo hapësirë publike në vlerë 5400 euro. Me nënshkrimin dhe vulën e Zyrës Komunale për Komunitete, me nënshkrimin e zv. kryesuesit të Komitetit për Komunitete që është komitet obligativ dhe nënshkrimin e drejtorit të Shërbimeve Publike është përmbyllur kjo çështje, tani ata e kanë marrë pëlqimin përvazhdimin dhe mbylljen e atij aktiviteti.

Vjollca Gurgule – Inderuar kryetar, drejtorë, kolegë nga OSBE, KFOR-ri, përshëndetje për komandantin e policisë. Ndoshta nuk lidhet shumë me KKSBB-në, megjithatë unë pata dëshirë t'iu njoftoj juve si kryetar i komunës. SLH-Kosova dihet që e ka një qendër në lagjen e epërme serbe. Donatorët që i kemi pas në kontinuitet na kanë ndihmuar

për renovim të asaj pjese për aktivitete të përbashkëta me komunitete. Pjesa që e kemi marrë me qira nga Mirjana është shitura dhe pronari i ri kërkon ta rris qiranë, gjë për të cilën ne nuk kemi fonde ta mbulojmë. Kështuqë e kemi një afat kohorë deri me datë 1 janar ta tërheqim inventarin që e kemi aty. Nuk ka të bëjë kjo aspak me atë që ka filluar të flitet, kinse ne do ta mbyllim këtë zyre. Vetëm për shkak të mungesës së fondeve nuk po arrijmë ta mbulojmë atë pjesë. Jemi në negociata me Gjermaninë – donatorin tonë gjerman që na ka mbështetur 23 vite dhe po shpresojmë që edhe kësaj here ta gjej një hapësirë për mbështetje sepse është shumë me rendësi për neve ta kemi një vend aty. E gjitha që dua të them është që nëse mbylllet ajo qendër, punëtorja jonë serbe që punon aty, kalon në qendrën poshtë te ne dhe me përgjegjësi të plotë e them që aspak nuk do t'i ndërprenjmë as me komunitetin serb as me atë romë. E dyta; Dua publikisht të ju falenderoj juve dhe DKRS-në që na kanë mbështetur me një aktivitet që e kemi mbajtur me të rinjtë me temën “Siguria nëpër shkolla”. Mbështetjen e kemi pas edhe nga drejtori i DKA-së ku prej 1 janarit do t'i mbajmë disa trajnime apo debate me psikologë të kontraktuar, t'i vërejmë problemet e fëmijëve që ndonjëherë po i demolojnë orët gjatë mësimit dhe pjesën teknike të shkollës. Në fund, ne po mbështetemi për një projekt përmes DKRS-së për një shfaqje teatrale dhe patë dëshirë t'i ftoj të gjithë anëtarët e KKSBB-së. Me datë 22 e kemi premierën me një regjisori profesional nga Tirana.

Lulzim Krasniqi – Përshëndetje për të gjithë. Më intereson të di rrith hapjes së korsisë së tretë në rrugën e UÇK-së te rrathi (ETC), realisht që të bëhet shenjëzimi i përkohshëm deri në finalizimin e rrugës sepse qarkullimi i mjeteve bëhet në mënyrë të pakontrolluar. Kjo formë mund ta parandaloj ndonjë aksident eventual.

Nysret Abazibra – Faleminderit kryetar, përshëndetje për të gjithë. I kisha ngriti dy çështje; Energjia elektrike dhe ndriçimi. Kohët e fundit kemi probleme me energji elektrike. Në lidhje me zbukurimet e fundvitit që zakonisht i bëjnë qytetaret, ndoshta kishte me qenë e udhës që të merret ndonjë vendim në kuadër të komunës, që për shkak krizës energetike të mos ndodhin zbukurimet me ndriçime duke kontribuar në kursimin e energjisë elektrike. E dyta; Mungesa e ndriçimit afër shkollës “Gëzim Hamza”. Meqenëse tanë gjatë dimrit mësimi mbahet deri në ora 17:00, nga ora 16:00-17:00 është terr, nxënësit që vijojnë në këtë shkollë gjatë kryerjes së mësimit nuk janë të sigurt për shkak të territ. Apeloj për intervenim në këtë lagje sa i përket ndriçimit.

Përparim Krasniqi – Përshëndetje për të gjithë. Sa i përket ndriçimit publik të rrugës “Gëzim Hamza”, për momentin nuk jemi duke punuar me kompaninë e mirëmbajtjes për shkak të neglizhencës të kompanisë në fjalë, mirëpo nga e hëna do të lidhim një kontratë të re dhe besoj që do të vazhdojmë me aktivitetin e rrymës dhe rregullimit të asaj hapësire. Te pyetje e Lulit; Me përmirësimin e kohës po presim ta bëjmë shenjëzimin me ngjyrë të verdhë (saritë), sepse në pranverë do të vendoset edhe shtresa e tretë e asfaltit dhe do të kompletohet.

Kryetari – Rruja katërt korsi, përkatësisht rruja tranzite e UÇK-së është duke u punuar dhe mezi ia kemi mbushur mendjen kompanisë t'ia nisë punimet sepse e dini arsyen e vetme, (rritje e çmimeve) që nuk korrespondon me kontratat që i kemi nënshkruar më herët. Ka ndodhur asfaltimi i shtresës së parë dhe të dytë, ndërkohë ka mbetur puna për shtresën e tretë dhe në fund shenjëzimi. Çka do të ndodh me rrith-rrotullimin? Ka me qenë krejtësisht tjetër, i standardeve dhe përmasave tjera të larta. Dekorim të qytetit sivjet nuk do të ketë, për arsyen e kursimit të energjisë. Do të ketë dekorim nga ana e bizneseve dhe shumë mirë që e bëjnë, por në mënyrë institucionale dëshirojmë ta justifikojmë vendimin e qeverisë rrith kursimit të energjisë elektrike.

3. Shqyrtimi dhe aprovimi i Planit të Punës së KKSBB-së për vitin 2023;

Kryetari – Ju e keni një plan të punës, të cilin e kemi diskutuar dhe të cilin do të kërkojmë që të miratohet në seancën e rregullt të kuvendit të komunës. Në çoftëse dikush ka ndonjë ide, plotësim apo vërejtje, sigurisht që ne do të dakordohemi bashkë. Në çoftëse jo, koordinatori Skender Hamza i ka dy çështje që ai mendon që duhet të përfshihen në planin vjetor të punës.

Skender Hamza – Përshëndetje kryetar, komandant, kolegë të pranishëm. Siç e dini, planin e punës iu kam dërguar para një javë, nga ana juaj e kam pritur ndonjë email (propozim) rrith planit të punës. Deri sot nuk e kam pranuar ndonjë email të tillë. Unë i kam paraparë dy pika shtesë, që mendoj që duhet të jenë në plan të punës;

- Mbrojtja e lumenjve që rrjedhin.
- Siguria dhe kontrolli i produkteve ushqimore.


Këto dy pika përshihen në shumicën e komunave, gjithashtu mendoj dhe besoj që edhe ne si komunë është mirë t'i kemi.

Kryetari – Pajtohem plotësisht, janë pika të mira dhe duhet të përfshihen në plan. Deri në datën e mbledhjes së kuvendit ju keni afat ta dorëzoni ndonjë propozim, ide, vërejtje, plotësim etj... Propozoj ta hedhim në votim dhe kërkoj miratimin e planit të punës duke përfshirë edhe këto dy pika, kush është për?... A ka votë kundër, abstenime?... Faleminderit shumë.

4. Të ndryshme;

Kryetari – A ka dikush ndonjë pikë, çështje për diskutim?... Nëse jo, unë ju ftoj të merrni pjesë me datë 20 dhjetor në ora 11:00, në sallën e kuvendit e kemi diskutimin publik për punën e kryetarit. Ka shumë tema që mund t'i diskutojmë rreth investimeve, projekteve, sfidave e shumë gjëra tjera. Faleminderit shumë, urime festat e fundvitit dhe mirutakofshim zyrtarisht në vitin e ardhshëm.

Mbledhja përfundoi në ora 16:05

 Procesmbajtësi Albion Krasniqi	 Kryetari i Komunës Smajl Latifi
--	--